


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Qershor 2019

**Tiranë, më 17 Korrik 2019:** Në Qershor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 4,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 8,2 %, në krahasim me Maj 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 53 mld lekë, duke u ulur me 1,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 9,6 %, në krahasim me Maj 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me Qershor 2018 dhe ulur me 10,8 %, në krahasim me Maj 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 152 mld lekë, duke u ulur me 3,7 %, krahasuar me një vit më parë, ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 318 mld lekë, duke u rritur me 2,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 165 mld lekë, duke u rritur me 9,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Ulja vjetore e eksporteve prej 4,4 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,7 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2019**




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë ulur me -3,7 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,2 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Ulja vjetore e importeve prej 1,5 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,6 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,0 pikë përqindje, etj.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2019**



Si gjashtëmuhor, importet janë rritur me 2,6 %, krahasuar me gjashtëmuhorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,7 pikë përqindje.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Qershor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2018 janë: Italia (0,3 %), Gjermania (12,6 %), dhe Kina (37,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova (-10,0 %), Spanja (-18,8 %) dhe Greqia (-1,8 %).

Gjatë këtij gjashtëmuhori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (28,7 %), Gjermania (2,8 %), dhe Maqedonia e Veriut (4,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-0,9 %), Spanja (-24,7 %) dhe Greqia (-6,5 %).

Në muajin Qershor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2018 janë: Kina (11,4 %), SHBA (12,7 %), dhe Spanja (73,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-8,9 %), Greqia (-10,6 %) dhe Turqia (-17,9 %).

Gjatë këtij gjashtëmuhori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (22,5 %), Greqia (10,2 %) dhe Turqia (6,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-8,0 %), Gjermania (-12,9 %) dhe Spanja (-12,1 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2019 (%)



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 65,7 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,7 %), Greqia (7,7 %), Kina (6,6 %), dhe Gjermania (6,3 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë 2018, me vendet e BE zënë 65,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar - Qershor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,7 %), Greqia (7,4 %), Kina (6,9 %) dhe Gjermania (6,2 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave**

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	Janar - Qershor 17	134	13,5	296	5,7	-162	45,2
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	Janar - Qershor 18	158	18,4	310	4,7	-151	51,1
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	25	-4,4	53	-1,5	-28	47,7
	Janar - Qershor 19	152	-3,7	318	2,6	-165	47,9

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Qershor 2018	Qershor 2019	Jan.- Qer. 2018	Jan.- Qer. 2019	Qershor 2018	Qershor 2019	Jan.- Qer. 2018	Jan.- Qer. 2019
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>20.324</b>	<b>19.472</b>	<b>122.092</b>	<b>116.577</b>	<b>34.553</b>	<b>32.361</b>	<b>193.902</b>	<b>189.589</b>
Austri	148	141	915	1.035	494	411	3.303	3.462
Mbretëri e Bashkuar	70	43	432	373	579	539	2.937	2.642
Gjermani	1.198	1.349	7.046	7.243	3.769	3.654	24.883	21.662
Greqi	1.142	1.122	6.864	6.418	5.547	4.960	25.658	28.278
Itali	12.514	12.548	76.382	75.722	16.250	14.801	89.885	82.661
Spanjë	2.022	1.643	12.656	9.529	1.252	1.072	6.529	5.738
Kroaci	67	138	426	599	365	634	2.575	3.371
Të tjera të BE-së	3.163	2.489	17.370	15.657	6.298	6.289	38.131	41.775
Kinë	265	364	3.369	3.085	4.312	4.804	24.057	29.459
Kosovë	2.562	2.306	11.175	14.380	699	677	3.857	3.698
Maqedonia e Veriut	717	630	4.031	4.201	836	756	4.381	4.271
Rusi	7	-	18	70	886	835	5.371	4.719
SHBA	462	158	2.402	1.923	642	724	4.525	5.258
Turqi	254	99	880	981	4.707	3.863	25.180	26.809
Ukrinë	31	15	125	109	430	280	1.312	1.469
Zvicër	24	73	2.214	410	607	1.068	4.972	8.211
Të tjera	2.012	2.366	11.438	10.525	6.492	8.003	41.973	43.300
<b>Gjithsej</b>	<b>26.657</b>	<b>25.481</b>	<b>158.070</b>	<b>152.263</b>	<b>54.164</b>	<b>53.372</b>	<b>309.530</b>	<b>317.618</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup - mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 2018	Qershor 2019	Jan.- Qer. 2018	Jan.- Qer. 2019	Qershor 2018	Qershor 2019	Jan.- Qer. 2018	Jan.- Qer. 2019
<b>Gjithsej</b>	<b>26.657</b>	<b>25.481</b>	<b>158.070</b>	<b>152.263</b>	<b>54.164</b>	<b>53.372</b>	<b>309.530</b>	<b>317.618</b>
Ushqime, pije, duhan	2.911	3.208	15.682	17.554	8.685	9.035	51.684	52.302
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.776	3.768	30.773	23.602	4.704	5.790	30.944	39.400
Produkte kimike dhe plastike	463	634	2.780	3.596	7.788	7.045	43.387	42.300
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	267	274	1.518	1.347	1.930	1.671	10.056	9.447
Prodhime druri dhe letre	678	778	4.289	4.721	2.041	2.259	11.752	12.102
Tekstile dhe këpucë	10.696	10.600	63.336	62.261	7.951	7.733	44.052	43.888
Materiale ndërtimi dhe metale	4.589	3.862	27.104	24.244	7.402	7.051	37.501	40.277
Makinëri, pajisje dhe pj. këmb.	1.635	1.516	8.422	10.390	11.525	10.676	68.233	66.218
Të tjera	641	841	4.166	4.548	2.137	2.113	11.922	11.684

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup - mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>76.382</b>	<b>75.722</b>	<b>11.175</b>	<b>14.380</b>	<b>12.656</b>	<b>9.529</b>	<b>7.046</b>	<b>7.243</b>
Ushqim. pije duhan	3.784	4.037	1.447	1.884	557	694	658	651
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.793	3.109	2.010	3.452	10.487	7.566	1.306	653
Produkte kimike dhe plastike	760	965	619	968	25	15	13	34
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.154	1.087	4	4	132	131	3	7
Prodhime druri dhe letre	2.991	3.278	219	370	3	3	74	79
Tekstile dhe këpucë	49.092	48.627	53	45	1.330	1.006	3.746	3.822
Materiale ndërtimi dhe metale	9.661	7.397	5.861	6.501	107	109	346	851
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	5.160	5.205	346	354	4	5	627	759
Të tjera	1.986	2.017	615	803	9	2	274	387

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup - mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>89.885</b>	<b>82.661</b>	<b>24.057</b>	<b>29.459</b>	<b>25.180</b>	<b>26.809</b>	<b>25.658</b>	<b>28.278</b>
Ushqim. pije duhan	8.818	9.387	326	433	2.902	2.716	7.670	7.554
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	6.995	3.456	3	2	406	385	3.968	7.341
Produkte kimike dhe plastike	9.114	9.057	2.356	2.674	3.830	3.598	3.851	3.746
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.737	7.565	361	390	157	117	40	17
Prodhime druri dhe letre	3.599	3.375	506	509	1.484	1.475	1.505	1.594
Tekstile dhe këpucë	22.446	21.349	4.621	5.477	7.842	8.562	1.925	1.867
Materiale ndërtimi dhe metale	10.829	9.892	3.123	5.030	3.661	5.503	4.356	4.038
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	17.291	16.030	10.430	12.227	3.687	3.398	1.424	1.316
Të tjera	3.057	2.550	2.329	2.717	1.212	1.056	921	805

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri